



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.907/11

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emini, në çështjen juridike të paditësve Z. G., Z. S. dhe R. S., të gjithë nga Prizreni, tani me vendbanim të përkohshëm në Beograd Republika e Serbisë, të cilët me autorizim i përfaqëson av. G. M. nga Shtërpca, përmes projektit të ndihmës juridike personave refugjatë, kundër të paditurve G. S., L. S., të dy nga fshati D. Komuna e Prizrenit, S. V. nga fshati M. Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av. E. G. nga Prizreni dhe M. P. nga fshati V. Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson P. P. nga Prizreni, me objekt të padisë anulimin kontratave mbi shitëblerjen e patundshmërisë, vlera e kontestit 216.000€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën **30.11.2015**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve Z. G., Z. S. dhe R. S., të gjithë nga Prizreni, **si e bazuar**.

a). VËRTETOHET se është nule kontrata mbi shitëblerjen e parc. kat. nr. 6615/1 ZK Prizren, Leg.nr.4696/06, datë 25.08.2006, e lidhur në mes të I. T. nga fshati G., Komuna e Prizrenit dhe të paditurit të parë G. S. nga fshati D., Komuna e Prizrenit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren.

b). DETYROHET i padituri G. S. që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, ta lirojë paluajtshmërinë-parc. kat. nr.6615/1, nga personat dhe sendet, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

c). Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral, si bashkëpronat të ngastrës së cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

II. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve Z. G., Z. S. dhe R. S., të gjithë nga Prizreni, **si e bazuar**.

a). VËRTETOHET se është nule kontrata mbi shitëblerjen e parc. kat. nr. 6615/1 ZK Prizren, Leg.nr.4901/06, datë 05.09.2006, e lidhur në mes të I. T. nga fshati G., Komuna e Prizrenit dhe të paditurit S. V. nga fshati M., Komuna e Prizrenit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren.

b). DETYROHET i padituri S. V. që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, ta lirojë paluajtshmërinë parc. kat. nr.6615/1, nga personat dhe sendet, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

c). Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral, si bashkëpronat të ngastrës së cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

III. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve Z. G., Z. S. dhe R. S., të gjithë nga Prizreni, **si e bazuar**.

a). VËRTETOHET se është nule kontrata mbi shitëblerjen e parc. kat. nr. 6615/1 ZK Prizren, Leg.nr.5445/06, datë 03.10.2006, e lidhur në mes të I. T. nga fshati G., Komuna e Prizrenit dhe të paditurit M. P. nga fshati V., Komuna e Prizrenit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren.

b). DETYROHET i padituri M. P. që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, ta lirojë paluajtshmërinë parc. kat. nr.6615/1, nga personat dhe sendet, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

c). Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral, si bashkëpronat të ngastrës së cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

IV. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve Z. G., Z. S. dhe R. S., të gjithë nga Prizreni, **si e bazuar**.

a). VËRTETOHET se është nule kontrata mbi shitëblerjen e patundshmërisë –shtëpisë në vendin e quajtur “M.”, në sipërfaqe prej 2,88 ari, oborr 5,00 ari dhe arës 17 m², e regjistruar në listën poseduese nr.76 ZK Prizre, Leg.nr.5566/06, datë 09.10.2006, e lidhur në mes të I. T. nga fshati G., Komuna e Prizrenit dhe të paditurit L. S. nga fshati D., Komuna e Prizrenit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren.

b). DETYROHET i padituri L. S. që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, ta lirojë paluajtshmërinë parc. kat. nr.2627, nga personat dhe sendet, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

c). Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral, si bashkëpronat të ngastrës së cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

V. OBLIGOHEN të paditurit G. S., L. S., S. V. dhe M. P., që në mënyrë solidare paditësve Z. G., Z. S. dhe R. S., t’ia kompensojnë shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1.913.00 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

VI. Aktvendimi C.nr.907/11, datë 08.11.2012, me të cilin është caktuar masa e sigurimit në këtë çështje kontestimore, mbetet në fuqi deri në plotëfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit Z. G., Z. S. dhe R. S., të gjithë nga Prizreni, me datë 17.09.2008, kanë parashtruar padi në gjykatë, ndaj të paditurve G. S., L. S., S. V. dhe M. P., me adresa të vendbanimit si në padi, me objekt të padisë anulimin e kontratave të shitëblerjes. Përmes padisë dhe kërkesëpadi së paditësit ndër të tjera kanë kërkuar anulimin e kontratave të cekura në pikën I, II, III dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lirim nga njerëzit dhe sendet të këtyre patundshmërive dhe obligimin e Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës në Komunën e Prizrenit që të regjistrojë sërish si pronar të ngastër kadastrale kontestuese paditësit, përfshirë këtu edhe kërkesën për shpenzime procedurale.

1. Juridiksioni dhe kompetenca e Gjykatës

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 11 parag. 1 të Ligjit për Gjykatat (nr. 03/L-199), nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur këtë çështje.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë nenin 17.2 të LPK-së: *“Vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata”*. Meqënëse ndodhemi përpara një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia e detyrimeve, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën territoriale nenit 53 i LPK-së thotë: *“Në kontestet për vërtetimin e ekzistimit apo mosekzistimit të kontratës, për përmbushjen apo zgjidhjen e kontratës, si dhe në kontestet për zhdëmtime të shkaktuar nga mos përmbushja e kontratës, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, e kompetencës territoriale është edhe gjykata e vendit ku sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese i padituri ka detyrë ta përmbushë kontratën”*. Meqënëse në rastin konkret kontratat për të cilat kërkohet anulimi i saj janë lidhur në Gjykatën Komunale në Prizren, marrë parasysh këtu edhe vendbanimet e palëve, rezultoi se kompetente në pikëpamje territoriale për shqyrtimin e kësaj çështjeje juridiko-civile është kjo gjykatë.

Paditësit, legjitimohen t'i drejtohen gjykatës me këtë padi pasi pretendojnë se të njëjtit kanë interes juridik që të vërtetohet se kontratat e lidhura janë absolutisht nule, marrë parasysh të drejtat e tyre pronësore të cilat i kanë pasur para lidhjes së kontratës. Pala e paditur ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike, pasi që të njëjtit kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuale me I. T., dhe e kanë regjistruar të drejtën e pronësisë në regjistrin kadastral të paluajtshmërive lëndore.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim.

2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit Z. G., Z. S. dhe R. S., të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqëson përmes projektit për ndihmë juridike të refugjatëve av. G. M., në shqyrtimin kryesor kanë deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar. Në padi kanë cekur se paditësit janë bashkëpronar me 1/3 të pjesës ideale të ngastrës kadastrale nr. 6615/1, në vendin e quajtur "P.", në sipërfaqe të përgjithshme prej 56,72 ari, e regjistruar sipas listës poseduese nr.75 ZK Prizren dhe pronar prej 1/9 të patundshmërisë nr. 2627, në vendin e quajtur "M.", shtëpi në sipërfaqe prej 2,88 m², oborr në sipërfaqe prej 5,00 ari dhe arë në sipërfaqe prej 17 m², të regjistruara në listën poseduese nr.76 ZK Prizren. Të paditurit në mënyrë jo ligjore-me mashtrim dhe falsifikim të autorizimit kanë vërtetuar kontratat mbi shitëblerjen e patundshmërisë dhe kanë bërë regjistrimin e të drejtës së pronësisë në patundshmëri dhe atë përmes autorizimeve të falsifikuara Leg.nr.158/06 datë 28.03.2006 dhe Leg.nr.452/06 datë 21.07.2006, i kanë vërtetuar kontratat mbi shitëblerjen si në vijim: kontratën Leg.nr.4696/06, datë 25.08.2006, kontratën Leg.nr. 4901/06, datë 05.09.2006, kontratën Leg.nr.5445/06, datë 03.10.2006 dhe kontratën Leg.nr.5566/06, datë 09.10.2006. Më tutje kanë shtuar se paditësit nuk i kanë nënshkruar këto autorizime I. T. nga fshati G. Komuna e Prizrenit, të cilët autorizime kinse ajnë vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj-Dega Shtërpçë, andaj edhe kontratat e cekura më lartë nuk kanë efekt juridik dhe duhet të anulohen bazuar në nenin 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ndër të tjera ka cekur se pa dijeninë e paditësve-pronarëve, në Gjykatën Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpçë, janë vërtetuar autorizimet e cekura më lartë, përmes të cilave I. T. është autorizuar që në cilësi të përfaqësuesit të pronarëve, mund të lidh kontratën mbi shitëblerjen e paluajtshmërisë. Këtë vërtetim e ka bërë personi zyrtar i kësaj gjykate N. H., i cili edhe më herët kishte kryer veprime të tilla të paligjshme, për çka edhe është dënuar. Edhe I. T. është aktor i shumë procedurave penale dhe civile, për shkak të transaksioneve mashtruese. Pra në Gjykatën Komunale në Prizren, në bazë të aktakuzës së Prokurorisë përkatëse, ndaj I. T. zhvillohet procedura penale P.nr.648/09. Ndërsa nëse ata kanë kryer çdo gjë në mënyrë të rregullt për lidhjen e punëve juridike, atëherë përse të njejtit janë në arrati dhe të paarritshëm për gjykatën. Në bazë të këtyre autorizimeve të rrejshme, në verën e vitit 2006, janë lidhur kontratat me të paditurit: G. S., L. S., S. V. dhe M. P. Rastësisht në vitin 2008, gjatë vizitës në Prizren, paditësit kanë kuptuar se pasuria nuk është më në emrin e tyre. Menjëherë, me datë 17.09.2008, kanë paraqitur kallxim penal dhe kanë ngritur padi në këtë çështje. Në atë kohë I. T. ka qenë i arrestuar dhe i paraburgosur, ndërsa ekziston edhe prova e marrjes në pyetje të tij në procedurën penale. Sipas fjalëve të tyre, ai në atë kohë ka pranuar se ka falsifikuar dokumentacionin, ndërsa pas ndërprerjes së paraburgimit i njëjti është në arrati dhe i paarritshëm për gjykatën, për çka edhe nuk ka pasur mundësi të përfundojë procedura penale ndaj tij në lëndën P.nr.648/09. Më tutje ka shtuar se asnjëri prej paditësve nuk kanë qenë në Shtërpçë, nuk kanë legalizuar

ndonjë autorizim për ndonjë person, për çka edhe është evidente se është fjala për falsifikim, kur përveç të akuzuarit I. T., është i përfshirë edhe N. H., i cili ka keqpërdorur detyrën zyrtare dhe ka legalizuar këto autorizime si të besueshme. Nga të cekurat në konstatimin e ekspertit të grafologjisë, paditësit konsiderojnë se është dëshmuar se të gjitha pohimet e tyre të bëra në procedurë janë të bazuara. Eksperti thekson se paditësit Z. G. dhe Z. S. nuk kanë nënshkruar asnjërin prej autorizimeve kontestuese. Sipas ekspertit paditësja R. S. nuk ka nënshkruar autorizimin kontestues të shënuar si provë A, ndërsa provën B në mënyrë të papërcaktuar thotë se “ka mundur të jetë e nënshkruar” nga ana e personit të njëjtë. Më tutje ka shtuar se të dy autorizimet kontestuese Vr.nr.452/06 dhe Vr.nr.158/06, nuk janë nënshkruar nga ana e pronarëve të ligjshëm, prandaj juridikisht janë nule. Autorizimet e tilla janë në kundërshtim edhe me parimet e rregullimit shoqëror, të përcaktuara me kushtetutë dhe me rregullat e moralit shoqëror. Punët juridike të cilat rrjedhin nga këto autorizime të kundërligjshme, po ashtu janë juridikisht nule dhe atë: kontrata Leg.nr.4696/06, datë 25.08.2006, kontrata Leg.nr. 4901/06, datë 05.09.2006, kontrata Leg.nr.5445/06, datë 03.10.2006 dhe kontrata Leg.nr.5566/06, datë 09.10.2006. Në këto rrethana nuk ekziston vullneti i palëve kontraktuese dhe baza e detyrimit kontraktues është e palejuar, ndërsa nga këto veti të tilla të kontratave del qartë edhe pasoja juridiko-civile-vërtetimi i nulitetit të tyre.

Në fund i propozuan gjykatës që të aprovojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, të përshkruar si në pikën I, II, III dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe të obligojë palën e paditur që solidarisht paditësve t'i paguajnë shpenzimet e procedurës, por pa e specifikuar shumën e tyre dhe atë për 10 seanca gjyqësore, për përpilimin e padisë, për përpilimin e 4 parashtresave të ndërlikuara, shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm për tri seanca dhe përpilim të parashtresave (më gjerësisht referoju deklarimeve të palës paditëse në shqyrtimet e mbajtura dhe parashtresave me shkrim të dorëzuar gjykatës).

I autorizuari i të paditurve G. S., L. S. dhe S. V., av. E. G. në shqyrtimin kryesor deklaroi se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, duke i propozuar gjykatës që pas vlerësimit të provave të administruara ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e tyre si të pabazuar. Në fjalën e fundit i njëjti ka deklaruar se pas administrimit të provave, sidomos kontratave të vërtetuara në Gjykatën Komunale në Prizren, autorizimeve të vërtetuara në gjykatën kompetente, si dhe ekspertizave të bëra në lidhje me nënshkrimet etj, konsideroj se ka ngelur pa u vërtetuar një çështje me shumë rëndësi për këtë çështje juridike dhe ajo është përgjegjësia penale juridike e nënshkruesit të kontratave në gjykatën kompetente, e të cilat janë lidhur ashtu siç kërkon ligji dhe jo vetëm. Pasi që jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet me demokraci të zhvilluar, kontrata me shkrim, e vërtetuar në organin kompetent, mjetet e lëshuara përmes bankës, vërtetimet nga organet kompetente të komunës nga të cilat ka rezultuar se këto prona kanë qenë të lira për qarkullim. Të gjitha këto veprime të bëra nga të paditurit janë bërë me mirëbesim. I padituri G. S. për blerjen e patundshmërisë e ka paguar shumën prej 56.730 euro, ndërsa më pas edhe e ka bartur të drejtën e pronësisë në emër të tij, duke investuar edhe një shumë të mjeteve për rrafshimin e kësaj ngastre dhe rrethimin e saj. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe i padituri S. V. Më tutje ka shtuar se i padituri L. S. e ka blerë shtëpinë prej ½ e kësaj patundshmërie, ndërsa pjesën tjetër prej ½ nuk ka dashur ta shes bashkëronari dhe me këtë rast janë njoftuar edhe trashëgimtarët kur është bërë shitëblerja e kësaj patundshmërie,

konkretisht parc. kad. Nr.2627 në vendin e quajatur "M." me kulturë shtëpi, e cila kontratë është vërtetuar në gjykatë. E metë e padisë është që ka qenë e domosdoshme që pjesë e saj të jetë edhe I. T. si nënshkrues i këtyre kontratave. Duke u bazuar në të gjitha këto të dhëna, pavarësisht ekspertizës në të cilën kemi vërejtje, apsi që e njëjta është jo e plotë, pasi disa nënshkrime kanë dalë identike e disa jo, e cila jep me dyshuar se a është kjo ekspertizë e plotë dhe a mund t'i falet besimi të njëjtës.

Meqenëse një raport civilo-juridik është kryer në vitin 2006 dhe gjendja faktike në terren para se të vendoset për masën e përkohshme të sigurimit ka ndryshuar, pasi që në këto ngastra janë ndërtuar disa shtëpi, banojnë njerëz në to, vlerat ekonomike të objekteve janë në disproporcion me vlerën e pronës, duke ju referuar edhe parimit "Superficio solo cedit". Në fund i ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit të provave të administruara të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, për faktin se të paditurit kontratat e tyre i kanë lidhur në mënyrë të rregullt në Gjykatën Komunale në Prizren, kanë paguar çmimin e shitëblerjes përmes bankës etj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për përfaqësim në 10 seanca gjyqësore sipas TA-së (më gjerësisht referojnë deklarimeve të av. E. G. në shqyrtimet e mbajtura).

I autorizuari i të paditurit M. P., P. P. në shqyrtimin kryesor deklaroi se mbetet në tërësi si në të cekurat gjatë shqyrtimeve të mbajtura, përmes të cilave e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, duke i mbështetur në tërësi deklarinë e dhënë nga i autorizuari i të paditurve av. E. G. në shqyrtimet e mbajtura dhe gjatë fjalës përfundimtare. Në fund i ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit të provave të administruara ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat si në vijim: autorizimin Vr.nr.452/06, datë 21.04.2006, autorizimin Vr.nr.158/06, datë 28.03.2006, kontratën mbi shitëblerjen e patundshmërisë Leg.nr.4901/06, datë 05.09.2006, e legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren, kontratën mbi shitëblerjen Leg.nr.5445/06, datë 03.10.2006, kontratën mbi shitëblerjen e patundshmërisë Leg.nr.4696/06, datë 25.06.2006, kontratën bi shitëblerjen e patundshmërisë Leg.nr.5566/06, datë 09.10.2006, çertifikatën e pronësisë nr. UL-71813068-00076, datë 31.07.2008, fletën poseduese nr. 76, datë 22.05.2007, aktvendimin e zyrës komunale të kadastrit në Prizren nr. 027 nr.1030/B, datë 08.05.2007, aktvendimin e zyrës komunale të kadastrit në Prizren nr. 027 nr.1281/B, datë 18.06.2007, provat materiale dhe përgjigjen e dhënë nga Gjykata Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpçë Agj.nr.25/2012, datë 07.05.2012, raportin e ekspertizës grafologjike të hartuar nga Njësia për Ekspertim traseologjik dhe daktiloskopik e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2003-3712/2013-2840, datë 23.04.2014, ekspertizën plotësuese grafologjike nr. AKF/2015-2639/2015-2465, datë 14.09.2015, ka dëgjuar ekspertën e cila ka hartuar këtë ekspertizë L. Sh., ka bërë shikimin e shkresave të lëndës penale P.nr.648/09.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore

(LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve **është tërësisht e bazuar, andaj e njëjta duhet të aprovohet.**

4. Faktet

Me shikimin në autorizimin Vr.nr.452/06, datë 21.04.2006, të legalizuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, Gjykata konstatoi faktin se nga përmbajtja e tij rezulton se këtu paditësit Z. G., Z. S. dhe R. S., e autorizojnë I. T. nga fshati G., Komuna e Prizrenit, që në emër të paditësve të shes patundshmërinë kontestuese nr.6615/1, në vendin e quajtur "P.", me kulturë arë e klasit të dytë, në sipërfaqe prej 56,73 ari, e evidentuar sipas listës poseduese nr.75 ZK Prizren, në pronësi të paditësve me nga 1/3 pjesë ideale.

Me shikimin në autorizimin Vr.nr.158/06, datë 28.03.2006, të legalizuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, Gjykata konstatoi faktin se nga përmbajtja e tij rezulton se këtu paditësit Z. G., Z. S. dhe R. S., e autorizojnë I. T. nga fshati G., Komuna e Prizrenit, që në emër të paditësve të shes patundshmërinë kontestuese nr.2627, në vendin e quajtur "M.", në sipërfaqe prej 8,05 ari, e evidentuar sipas listës poseduese nr.76 ZK Prizren, në pronësi të paditësve prej 2/18 pjesë ideale.

Me shikimin e kontratës mbi shitëblerjen Leg.nr.4696/2006, datë 25.08.2006, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, Gjykata vërtetoi faktin se I. T. si i autorizuar i paditësve (në bazë të autorizimit Vr.nr.452/06), i shet të paditurit G. S., sipërfaqen prej 18.91 ari, të ngastrës nr.6615/1, në shumë prej 56.730,00 euro.

Me shikimin e kontratës mbi shitëblerjen Leg.nr.4901/2006, datë 05.09.2006, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, Gjykata vërtetoi faktin se I. T. si i autorizuar i paditësve (në bazë të autorizimit Vr.nr.452/06), i shet të paditurit S. V., sipërfaqen prej 18.91 ari, të ngastrës nr.6615/1, në shumë prej 56.730,00 euro.

Me shikimin e kontratës mbi shitëblerjen Leg.nr.5445/2006, datë 03.10.2006, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, Gjykata vërtetoi faktin se I. T. si i autorizuar i paditësve (në bazë të autorizimit Vr.nr.452/06), i shet të paditurit M. P., sipërfaqen prej 18.91 ari, të ngastrës nr.6615/1, në shumë prej 56.730,00 euro.

Me shikimin e kontratës mbi shitëblerjen Leg.nr.5566/2006, datë 09.10.2006, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, Gjykata vërtetoi faktin se I. T. si i autorizuar i paditësve (në bazë të autorizimit Vr.nr.158/06), i shet të paditurit L. S., shtëpinë në sipërfaqe prej 2.68 ari, oborr në sipërfaqe prej 5.00 ari dh arë të kl. 1, në sipërfaqe prej 0.017 ari, apo në sipërfaqe të përgjithshme prej 8.05 ari, të ngastrës nr.2627 ZK Prizren, në shumë prej 46.600,00 euro.

Nga leximi i çertifikatës së pronësisë nr. UL-71813068-00076, datë 31.07.2008, gjykata vërtetoi faktin se i padituri L. S., regjistrohët si pronar në regjistrin kadastral, i pjesës ideale prej 3/9, i ngastrës nr.2627 ZK Prizren.

Nga leximi i çertifikatës së pronësisë nr. UL-71813068-00075, datë 31.07.2008, gjykata vërtetoi faktin se i paditurit G. S., M. P. dhe S. V., regjistrohen si pronar në regjistrin kadastral, me nga 1/3, të pjesës ideale, të ngastrës nr.6615/1 ZK Prizren.

Nga leximi i aktvendimit të zyrës komunale të kadastrit në Prizren nr. 027 nr.1030/B, datë 08.05.2007 dhe aktvendimit të zyrës komunale të kadastrit në Prizren nr. 027 nr.1281/B, datë 18.06.2007, Gjykata vërtetoi faktin se Zyra Komunale e Kadastrit në Prizren, i ka aprovuar kërkesat e të paditurve për bartjen e të drejtës së pronësisë nga paditësit tek të paditurit.

Nga leximi i provat materiale dhe përgjigjes së dhënë nga Gjykata Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpçë Agj.nr.25/2012, datë 07.05.2012, gjykatës i rezultoi se autorizimet Vr.nr.452/06 dhe Vr.nr.158/06, janë evidentuar në regjistrin përkatës të Gjykatës Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpçë, ndërsa kopjet e këtij regjistri gjenden në shkresat e lëndës.

Në raportin e ekspertizës grafologjike të hartuar nga Njësia për Ekspertim traseologjik dhe daktiloskopik e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2003-3712/2013-2840, datë 23.04.2014, ndër të tjera konstatohet shenjat e gishtërinjëve të personit Z. G., nuk kanë karakteristika të mjaftueshme për krahasim-eliminim, pasi gjurmët e vijave papilare janë marr në mënyrë jo profesionale nga ana e personit zyrtar. Shenjat e gishtërinjëve të Z. S. janë të kualitetit të dobët, për çka nuk ka pasur karakteristika të mjaftueshme për krahasim-eliminim (më gjerësisht referoju ekspertizës në fjalë e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Në raportin e ekspertizës së hartuar nga Sektori për ekspertim të dokumenteve dhe dorëshkrimeve, date 08.04.2014, ndër të tjera konstatohet se në bazë të rezultatit të ekspertimit shkrimet/nënshkrimet tek emri Z. G. në dëshmitë H dhe J dhe shkrimet/nënshkrimet mostra nga dëshmia K mund të jenë shkruar nga i njëjti shkruar. Në bazë të rezultatit të ekspertimit konstatohet se shkrimet/nënshkrimet tek emri Z. G. në dëshmitë A,B,C,D,E,F,G, I dhe shkrimet/nënshkrimet nga dëshmia K, nuk janë shkruar nga shkruari i njëjtë. Në bazë të rezultatit të ekspertimit konstatohet se shkrimet/nënshkrimet tek emri dhe mbiemri "Z. S." në dëshmitë C, D, E, H, I, J dhe shkrimet/nënshkrimet tek mostra L, mund të jenë shkruar nga shkruari i njëjtë. Në bazë të rezultatit të ekspertimit konstatohet se shkrimet/nënshkrimet tek emri dhe mbiemri "Z. S." në dëshmitë A, B, F, G dhe shkrimet/nënshkrimet nga dëshmia L, nuk janë nënshkruar nga shkruari i njëjtë. Në bazë të rezultatit të ekspertimit konstatohet se shkrimet/nënshkrimet tek emri "R. S." në dëshmitë B, F, G, H, J dhe shkrimet/nënshkrimet nga dëshmia M, mund të jenë nënshkruar nga shkruari i njëjtë. Në bazë të rezultatit të ekspertimit konstatohet se shkrimet/nënshkrimet tek emri "R. S." në dëshmitë A, C, D, E dhe shkrimet/nënshkrimet nga dëshmia M, nuk janë shkruar nga shkruari i njëjtë. Ndërsa bazuar në factored e lartcekur, lidhur me nënshkrimin e fundit në pjesën "PRODAVCI", rezultati është pa konkludim (më gjerësisht referoju ekspertizës të cekur më lartë).

Në raportin plotësues të ekspertizës i hartuar nga Sektori për Ekspertim të Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, me nr. AKF/2015-2939/2015-2465, date 14.09.2015, e nënshkruar nga ekspertja L. Sh., ndër të tjera janë konstatuar të njëjtat të gjetura të cilat janë cekur në raportin e ekspertizës së datës 08.04.2014 (më gjerësisht referoju kësaj ekspertize e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Ekspertja L. Sh., e cila është edhe hartuesja e ekspertizave të cekura më lartë, në shqyrtimin kryesor të datës 29.04.2015 dhe 04.11.2015, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në të cekurat e kësaj ekspertize, ndërsa në detaje ka shpjeguar metodat e përdorura për hartimin e ekspertizave, si dhe është përgjigjur në pyetjet e palëve në lidhje me të gjeturat e ekspertizës (më gjerësisht referoju deklaratave të dhëna në shqyrtimin kryesor nga ana e ekspertës së cekur më lartë)

Nga shikimi i shkresave të lëndës penale P.nr.648/09, gjykata mori informacion për rrjedhën e procedurës penale të inicuar ndaj I. T. nga fshati G. Komuna e Prizrenit, për veprën penale të mashtrimit. Nga shkresat e kësaj lënde, rezultoi se procedura penale e cekur më lartë ende nuk ka përfunduar, për shkak se I. T. që nga momenti i ndërprerjes së masës për sigurimin e prezencës së tij, i njëjti është në arrati dhe deri në marrjen e këtij aktgjykimi, i njëjti është i paarritshëm për gjykatën. Gjykata i kushtoi vëmendje të veçantë aktakuzës së ngritur ndaj I. T., deklaratës së tij të dhënë në organet hetimore, deklaratave të këtu të paditurve G. S. etj, deklaratën e dëshmitarit R. B. nga fshati M. Komuna e Suharekës, si dhe deklaratat e dhëna nga këtu paditësit Z. G. etj (më gjerësisht referoju shkresave të lëndës penale P.nr.648/09).

5. Baza ligjore

Në këtë çështje juridike kontestimore do të zbatohen dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të vitit 1978, për shkak se marrëdhënia detyrimore kontestuese është krijuar në kohën kur ka qenë në fuqi ky ligj. Bazuar në nenin 12 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), *“Në themelimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe të detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe të ndershshmërisë.”* Sipas nenit 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është e paraparë se se *“Vullneti për të lidhur kontratën mund të deklarohet me fjalë, me shenjat e zakonshme ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij”*. Neni 51 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978, shprehimisht thotë: *“Secili detyrim duhet të ketë bazën e lejueshme, baza është e palejueshme po që se është në kundërshtim me parimet e rregullimit shoqëror, të përcaktuara në kushtetutë, me dispozita të dhunshme dhe me rregullat e moralit, ndërsa presupozohet se detyrimi është i bazuar megjithëse nuk është shprehur”*. Ndërsa neni 52 i po këtij ligji thotë se *“Në qoftë se baza nuk ekziston, ose është e palejueshme, kontrata është nul”*. Më tutje neni 56 parag. 1 i LMD-së thotë: *“Për lidhjen e kontratës së plotëfuqishme nevojitet që kontraktuesi të ketë zotësinë për të vepruar që kërkohet për lidhjen e kësaj kontrate”*. Nenet 84 deri 94 të LMD-së rregullojnë çështjen e përfaqësimit në përgjithësi dhe prokurën (autorizimin).

Më tutje neni 103 parag. 1 i LMD-së shprehimisht thotë: “Kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë, me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë është nul, në qoftë se qëllimi i rregullës së shkelur nuk pasjell ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon doçka tjetër”, ndërsa parag. 2 i këtij neni thotë: “Në qoftë se lidhja e kontratës së caktuar është e ndaluar vetëm për njëërën anë, kontrata do të mbetet në fuqi, në qoftë se në ligj nuk është parashikuar diçka tjetër për rastin e caktuar, ndërsa pala që e ka shkelur ndalesën ligjore do të pësojë pasoja përkatëse”.

Në nenin 111 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në mënyrë decisive është paraparë se “kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është e caktuar me këtë ligj ose dispozitë të veçantë”. Ndërsa me nenin 117 të po këtij ligji parashihet se “e drejta për të kërkuar anulimin e rrëzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkaku i rrëzueshmërisë, respektivisht pushimit të dhunës. Kjo e drejtë në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 3 vitesh nga data e lidhjes së kontratës”.

Ligji i Marrëdhënieve Themelore Juridike Pronësore (LMTHJP), i vitit 1980, në nenin 37 thotë: “Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet në zotërim faktik të të paditurit...”

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 46 parag. 1 thotë: “E drejta e pronës është e garantuar”, ndërsa parag. 3 thotë: “**Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona.** Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet”.

Protokolli 1 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në nenin 1 thotë: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

6. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, e njëjta duhet të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Ne rastin konkret gjykata e ka vërtetuar nulitetin e kontratës së shitblerjes për paluajtshmëritë kontestuese, ngase për lidhjen e këtyre të fundit nuk janë plotësuar kushtet e përgjithshme, respektivisht nuk janë plotësuar elementet qenësore të kontratës së shitblerjes, të parapara me dispozitat ligjore të lartëcituarra të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së).

Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, është vërtetuar se këtu paditësit asnjëherë nuk e kanë autorizuar I. T. nga fshati G., Komuna e Prizrenit, për shitjen e ngastrave kadastrale, të cilat janë objekt i kontratave të kontestuara. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, e sidomos përmes ekspertizës grafologjike të hartuar nga Njësia për Ekspertim traseologjik dhe daktiloskopik e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2003-3712/2013-2840, date 08.04.2014 dhe asaj plotësuese me nr. AKF/2015-2939/2015-2465, date 14.09.2015, nga të cilat pa mëdyshje është vërtetuar se paditësit Z. G. dhe Z. S. nuk kanë nënshkruar asnjërin prej autorizimeve kontestuese. Sipas ekspertizës paditësja R. S. nuk ka nënshkruar autorizimin kontestues të shënuar si provë A, ndërsa provën B në mënyrë të papërcaktuar konstatohet se *“ka mundur të jetë e nënshkruar” nga ana e personit të njëjtë.* Edhe nga ekspertiza grafologjike e hartuar nga Njësia për Ekspertim traseologjik dhe daktiloskopik e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2003-3712/2013-2840, datë 23.04.2014, nuk ka mundur të konstatohet se shenjat e gishtërinjëve të paditësit Z. G. dhe Z. S., të jenë të njëjta me shenjat e gishtërinjëve të vëna në autorizimet kontestuese, për arsyet e cekura në këtë ekspertizë.

Se autorizimet kontestuese nuk i kanë nënshkruar këtu paditësit, gjykata i vërtetoi edhe me provat e tjera të administruara, siç janë në rastin konkret shkresat penale P.nr.648/09. Në këtë drejtim, në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Komunale në Prizren PP.nr.1881/08, datë 30.04.2009, konstatohet fakti se ndaj I. T., është ngritur aktakuzë për shkak të kryerjes së veprës penale të mashtrimit, pasi që siç përshkruhet në dispozitivin nr. I, II, III, IV, V dhe VI, të aktakuzës, *“i njëjti me autorizimet e falsifikuara Vr.nr.452/06 dhe Vr.nr.158/06, të vërtetuara në Gjykatën Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpçë, ia shet të dëmtuarve këtu të paditurve G. S. etj, ngastrat kadastrale pronë e këtu paditësve, përkundër shumës së caktuar të parave...”*. Edhe vet I. T. në deklaratën e dhënë para prokurorit të çështjes, me datë 07.08.2008, ka pranuar se këtu paditësit i kanë dhënë autorizim vetëm R. B., në bazë të të cilit autorizim ky i fundit është dashur që të rregulloj çështjen e trashëgimisë së paraardhësit të këtu paditësve, ndërsa përveç autorizimit këtu paditësit kanë nënshkruar një parakontratë me R. B. për shitblerjen e ngastrave kontestuese dhe për këtë çështje R. B. i ka paguar paditësve në emët të kaparit shumën prej 5.000 euro. Më tutje në këtë deklaratë ka pranuar se pas tërheqjes nga autorizimi dhe parakontrata, i njëjti ka marrë autorizimet kontestuese në Gjykatën Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpçë, mirëpo askund nuk e përmend faktin se paditësit kanë qenë prezentë me rastin e marrjes së këtyre autorizimeve. Edhe në deklaratën e dhënë nga I. T. në polici, me datë 04.08.2008, ka theksuar se autorizimin ia ka bartur kinse R. B., ndërsa nuk ka pohuar se këto autorizime janë dhënë nga vet paditësit¹. Gjithashtu e ka

¹ Tërheqja nga autorizimi i R. B. është bërë me date 20.07.2006, ndërsa autorizim kontestues Vr.nr.158/06, është bërë me date 28.03.2006 dhe Vr.nr.452/06, është bërë me date 21.07.2006, që do të thotë se në rastin

pranuar faktin se pa dijeninë e R. B. dhe paditësve i ka shitur pronat kontestuese këtu të paditurve dhe nga këta të fundit ka marr edhe shumën e caktuar të parave, mirëpo asnjëherë nuk ia ka dhënë këto para paditësve, por i ka mbajtur për vete. Faktin se këtu paditësit nuk i kanë dhënë autorizimet kontestuese I. T., e konfirmon edhe R. B. në deklaratën e tij të dhënë para prokurorit kompetent, me datë 13.08.2008, ku ndër të tjera i njëjti ka deklaruar se ngastrat e këtu paditësve i ka blerë ai personalisht, për shumën e përgjithshme prej 221.224 euro, ndërsa nga kjo shumë paditësve i ka paguar 5.000 euro në emër të kaparit, mirëpo më vonë është tërhequr nga kjo shitëblerje. Më tutje R. B. ka sqaruar se ka kryer procedurën e trashëgimisë në emër të paditësve në gjykatë, ndërsa pjesën tjetër të punëve e ka kryer I. T. Më tutje i njëjti ka sqaruar se me I. T. kanë shkuar në Shtërpcë, ndërsa me I. ka qenë edhe Sh. A., kurse tek një avokat ka shkruar një deklaratë të cilën e ka vërtetuar në Gjykatë, përmes të cilës është tërhequr nga autorizimi dhe parakontrata (Vr.nr.448/06). R. B. ka deklaruar se nuk i ka bartur autorizimin e marrë nga paditësit I. T. apo ndonjë personi tjetër. Faktin se këtu paditësit nuk i kanë dhënë autorizimet kontestuese I. T., e konfirmojnë edhe vet R. S. dhe Z. S., përmes deklaratës së tyre të dhënë para prokurorit kompetent, me datë 05.09.2008 (por edhe para policisë). Të njëjtat ndër të tjera kanë konfirmuar deklaratimet e dhëna nga R. B., por kanë mohuar t'i kenë dhënë ndonjë herë autorizim I. T. për shitjen e pronave të tyre, apo të kenë pranuar ndonjë shumë parash nga ky i fundit në emër të shitjes së pronave të tyre.

Nga të gjitha faktet e cekura më lartë, të cilave gjykata ia fali besimin e plotë, pa mëdyshje është vërtetuar se të dy autorizimet kontestuese Leg.nr.452/06 dhe Leg.nr.158/06, nuk janë nënshkruar nga ana e pronarëve të ligjshëm, prandaj juridikisht janë nule.

Nga kjo rrjedhë se kontrata Leg.nr.4696/06, datë 25.08.2006, kontrata Leg.nr. 4901/06, datë 05.09.2006, kontrata Leg.nr.5445/06, datë 03.10.2006 dhe kontrata Leg.nr.5566/06, datë 09.10.2006, nuk ekzistojnë – konsiderohet se nuk janë lidhur asnjëherë në mes të paditësve dhe të paditurve G. S., L. S., M. P. dhe S. V., për shkak se ata as që e kanë nënshkruar atë (paditësit), e krejt kjo ngase të njëjtit asnjëherë nuk e kanë autorizuar askënd që në emër të tyre të lidhin kontratat mbi shitblerjen paluajtshmërisë së tyre. Gjykata vlerëson se në rastin në fjalë, nuk ka ekzistuar njëra palë kontraktuese, gjegjësisht nuk ka ekzistuar vullneti i njëjës palë, për ç'arsye edhe këto kontrata nuk ekzistojnë. Si rezultat i të lartëcekurave del se në këtë rast, ndër të tjera, ka munguar edhe baza (e lejueshme) e kontratave, ngase në mungesë të palës kontraktuese konsiderohet se ka munguar edhe qëllimi juridik që e ka shtyer subjektin përkatës (në këtë rast paditësit), që të krijoj të drejta dhe të marrë detyrime, elemente këto të cilat i japin karakterin juridik punës së caktuar juridike. Në mungesë të bazës së kontratës, e cila mes tjerash duhet të jetë edhe e lejueshme, kontrata konsiderohet të jetë nule. Prandaj, sipas vlerësimit përfundimtar të kësaj gjykate, kontratat e shitblerjes e të cilat janë objekt i këtij kontesti, nuk mund të ekzistojnë, të njëjtat konsiderohen të jenë nule, ngase nuk i përmbajnë elementet esenciale të lartpërmendura, të cilat duhet t'i përmbaj secila kontratë, nga ku edhe del përfundimi se “*quad nullum est, nullum producit effectum*”.

konkret nuk mund të ketë bartje të autorizimit nga R. B. tek I. T., ashtu siç ka pretenduar në prokurori ky i fundit.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur të dhënë në shqyrtimin kryesor, e të cilat kanë të bëjnë me lidhjen e kontratave kontestuese sipas mënyrës së paraparë me ligj, pagimin në tërësi të çmimit të shitëblerjes nga ana e të paditurve, mirëbesimin e të paditurve etj, të cilat pretendime nuk ishin kontestuese edhe për gjykatën (sidomos në raport me veprimet e të paditurve). Mirëpo, siç e kemi cekur edhe më lartë, në këtë procedurë është vërtetuar fakti se bartja e të drejtë së pronësisë tek këtu të paditurit është bërë përmes autorizimeve të falsifikuara nga I. T., e që nënkupton faktin se pronarët e ligjshëm (këtu paditësit) nuk kanë qenë në dijeni për këto veprime të paligjshme të I. T., si dhe nuk e kanë dhënë pëlqimin më vonë që eventualisht të pajtohen me këto veprime të ndërmarra pa dijeninë dhe pëlqimin e tyre, ashtu siç parasheh dispozita e nenit 88 të LMD-së. Përkundër faktit se këtu të paditurit konsiderohen të jenë me mirëbesim, kjo nuk do të thotë që pronarët e ligjshëm të mos kenë të drejtën e tyre për mbrojtjen e të drejtave që ndërlidhen me pasurinë e tyre.

Kjo e drejtë paditësve i garantohet me dispozitat ligjore të LMD-së, nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me protokollin 1 neni 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe jo vetëm (të cilat janë përmendur më lartë), të cilat garantojnë të drejtën e pronarëve të ligjshëm që ta gëzojnë paqësisht pronën e tyre, duke i garantuar atyre edhe mbrojtjen adekuate gjyqësore në raport me të drejtat e tyre pronësore, në rastet kur cenohen të njëjtat. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur që, nëse ndërhyrja në gëzimin e papenguar të posedimit shkaktohet nga një person privat, atëherë mbi autoritetet vendoset obligimi pozitiv për të garantuar që në sistemin e tyre ligjor *“të drejtat pronësore janë të mbrojtura sa duhet me ligj dhe ekzistojnë mjetet adekuate juridike përmes të cilave viktimat e ndërhyrjes mund të kërkojnë rivendosjen e të drejtave të saj, duke përfshirë edhe kërkesën e mundshme për kompensim të dëmit për çfarëdo humbje të pësuar”*, **(shih paragrafin 67 të aktgjykimit të GJEDNj në rastin Blumberga kundër Lituanisë, i datës 14 tetor 2008)**. Kjo edhe për faktin se askush nuk ka të drejtë që të tjetërsojë të drejtat e pronësisë për çfardo llojë prone tek personat e tretë, në kundërshtim me vullnetin e vet pronarit apo pa pëlqimin e tij. Nëse nuk do të respektoheshin këto parime, atëherë do të rrezikohej rendi juridik i shtetit dhe siguria juridike e të drejtave të qytetarëve në raport me pronat e tyre dhe jo vetëm. Përveç të cekurave më lartë, gjykata vlerëson se ky aktgjykim (në rast se bëhet i formës së prerë) nuk do të ju cenojë të drejtat e këtu të paditurve për të kërkuar të drejtat e tyre legjitime (kompensim adekuat) nga personi (I. T.), për dëmet e shkaktuara financiare dhe jo vetëm.

Gjykata i mori parasysh pretendimet e palës së paditur për sa i përket mos përfundimit të çështjes penale dhe vërtetimit të fajësisë për veprimet e paligjshme të I. T. Për këtë edhe kjo gjykatë i ka ndërmarr të gjitha veprimet e mundshme për të pasur së paku prezent I. T. për tu dëgjuar si dëshmitar, por nga përgjigjja e policisë ka rezultuar se i njëjti është i pakapshëm për organet e rendit (provat përkatëse gjenden në shkresat e lëndës). Sigurisht që do të ishte më e lehtë edhe për gjykatën që të vendoste në këtë çështje kontestimore, sikurse paraprakisht të vendosej çështja penale P.nr.648/09 dhe fajësia e I. T. Mirëpo, siç e kemi cekur edhe më lartë, gjykata ka pasur prova të mjaftueshme përmes të cilave e ka vërtetuar faktin se autorizimet kontestuese janë falsifikuar

nga I. T., ndërsa është obligim i gjykatës që për çështje të tilla kontestimore të vendos brenda një afati të arsyshëm, ashtu siç kërkon neni 6 i Konventës së cekur më lartë. Në të kundërtën do të cenoheshin të drejtat legjitime të këtu paditësve².

Ndërsa në lidhje me deklarinimin e të autorizuarit të paditurve av. E. G. të bërë në fjalën përfundimtare se gjykata është dashur të dalë në vend me ekspertët përkatës, pasi që ka ndryshime në teren para se të caktohej masa e përkohshme e sigurimit, gjykata konsideron se i njëjti deklarinim nuk qëndron. Kjo për faktin se gjatë tërë zhvillimit të procedurës (përkundër dhënjës së mundësisë nga gjykata), asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk i ka propozuar gjykatës që të marrë edhe këtë provë. Sipas nenit 7 paragraf.1 të LPK-së, janë palët ato që kanë për obligim që të propozojnë prova përmes të cilave synojnë të vërtetojnë faktet e caktuara, e jo gjykata, pasi kjo e fundit nuk ka autorizim ligjor që ex officio të marr prova të caktuara në procedurën kontestimore, përjashtimisht në rastet kur plotësohen kushtet ligjore të parapara me paragraf. 3 të nenit 7 të LPK-së (e që i referohet disponimit të palejueshëm të palëve). Ndërsa duke marr parasysh natyrën e këtij kontesti, gjykata konsideron mos dalja e gjykatës në vend nuk ka ndikim në mënyrën e vendosjen në këtë çështje.

Gjykata i ka pasur parasysh dhe në të njëjtën kohë i ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse (përveç atyre të cekura më lartë), përfshirë këtu edhe shkresën e Gjykatës Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, së bashku me provat përcjellëse Agj.nr.25/2012, datë 07.05.2012, mirëpo erdhi në përfundim se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen meritore të çështjes kontestuese.

Gjykata vendosi si në pikën **VI** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi erdhi në përfundim se është e nevojshme që masa e sigurimit e caktuar me aktvendimin C.nr.907/11, datë 08.11.2012, të mbetet në fuqi deri në plotëfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, në mënyrë që të shmanget ndonjë dëm eventual që mund të pësojnë paditësit.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 449, 452.1 dhe 463 të LPK-së dhe TA-së, ku e obligoi palën e paditur që në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet e procedurës këtu paditësve, dhe atë për përfaqësim në 10 seanca gjyqësore të mbajtura nga 135 €, dhe për tri parashtrësia të përpiluara nga 104 €, për shpenzimet e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit G. S., shumën 251 euro (përgjigje në padi dhe përfaqësim në dy seanca gjyqësore) apo shumën e përgjithshme prej 1.913.00 €. Gjykata nuk e aprovoi kërkesën e palës paditëse për kompensimin e shpenzimeve për përpilimin e padisë, pasi që e njëjta nuk mban vulën e avokatit.

² Edhe ashtu lënda penale P.nr.648/09, është afër arritjes së afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, për shkak se I. T. për momentin është i pakapshëm nga organet e rendit. Ndërsa gjykata dy here e ka ndërprerë procedurën në këtë çështje juridike për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake penale, por gjykata e shkallës së dytë e ka kthyer lëndën në rigjykim me kërkesë që të vazhdohet procedura pavarësisht zhvillimit të procedurës penale.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura në pikën 5 të arsyetimit të këtij aktgjykimi, lidhur me nenet 2, 4, 10 dhe 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.907/11, datë 30.11.2015

Procesmbajtësja,
Raxhije Emini

Gjyqtari,
Lumni Sallauka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.